



DEKLARATË E PËRBASHKËT
NGA KONFERENCA E NIVELIT TË LARTË PËR PERSONAT E ZHVENDOSUR NGA KOSOVA
27-28 NËNTOR 2014
SHKUP

Me rastin e Konferencës së Nivelit të Lartë të organizuar nga OSBE për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova, delegacionet pjesëmarrëse, të udhëhequra nga Ministri Dalibor Jevtic (Prishtinë), Drejtori Marko Gjuriq (Beograd), Zëvendës Ministri Ibrahim Ibrahimi (Shkup) dhe Drejtori Zheljko Shofranac (Podgoricë) bënë thirrje për përkushtim të shtuar politik dhe më shumë përpjekje për të adresuar nevojat e personave të zhvendosur.

Qëllimi i takimit ishte lehtësimi i diskutimeve të nivelit të lartë dhe promovimi i bashkëpunimit ndër-qeveritar për të ofruar zgjidhje të qëndrueshme. Bazuar në prezantimet e pjesëmarrësve dhe diskutimet e mbajtura, ekziston një konsensus i qartë se nevojitet bashkëpunim më i madh ndër-qeveritar dhe vullnet i fuqishëm nga të gjitha palët për të vazhduar thellimin e bashkëpunimit në nivelin politik dhe atë teknik.

Duke pasur parasysh morinë e gjerë të çështjeve që i afektojnë personat e zhvendosur nga Kosova, pjesëmarrësit vënë në pah se bashkëpunimi që nevojitet për të nxitur zgjidhje të qëndrueshme duhet të përfshijë promovimin e kushteve për kthim dhe përkrahjen e opsionit për integrim në vendin ku ata janë zhvendosur.

Në këtë kontekst, delegacionet u pajtuan të themelojnë një Forum të Nivelit të Lartë për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova që do të takohet në mënyrë periodike për të shqyrtuar përparimin e arritur në nivelin teknik, dhe për të ofruar udhëzime shtesë dhe përkrahje politike.

Përveç kësaj, delegacionet u pajtuan që të themelojnë një Grup Punues Teknik për Zgjidhje të Qëndrueshme për Personat e Zhvendosur nga Kosova. Pjesëtarët e Grupit Punues Teknik do të takohen në baza mujore për të adresuar çështjet specifike të identifikuara, temë për temë. Përbërja e Grupit Punues Teknik në mbledhje të ndryshme do të varet nga çështja që do të adresohet. Të gjithë anëtarët e Grupit Punues Teknik do të takohen së paku në kontekst të forumit të nivelit të lartë politik.

Ndër çështjet e ngritura që kërkojnë bashkëpunim ndër-qeveritar janë: të drejtat pronësore, alokimi i tokës, qasja në shërbime dhe dokumente civile, çështjet e strehimit, dhe modalitetet për shkëmbim të informatave. Përveç kësaj, pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për përfundimin e proceseve që janë duke u zhvilluar dhe pjesën e mbetur të rasteve nga qeveritë në Shkup dhe Podgoricë me përkrahje të partnerëve ndërkombëtar.

Delegacionet dëshirojnë të falënderojnë OSBE-në për organizimin e kësaj konference, dhe UNHCR-në për përkrahje, si dhe të gjithë pjesëmarrësit për kontributet e tyre të çmuara dhe angazhimin e vazhdueshëm.